



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KAMËZ**

PROCESVERBAL

**KONSULTIM PUBLIK PËR PROJEKT-BUXHETIN E VITIT 2025 PËR NJËSINË
ADMINISTRATIVE PASKUQAN**

I mbajtur më 16.10.2024, në orën 16:30 , në dëgjuesën me banorët e Njesisë Administrative Paskuqan, në lidhje me projekt-buxhetin e vitit 2025.

Takimi u zhvillua në Parkun e Liqenit të Paskuqanit.

Të pranishëm në takim ishin:

- Kryetari i Bashkisë së Kamëz, Z. Rakip Suli;
- Administratori i Njesisë Administrative Paskuqan, Z. Fatjon Kordhaku;
- Kryetari i Këshillit Bashkiak Kamëz, Z. Hysen Koldashi;
- Anëtarët e Këshillit Bashkiak Kamëz;
- Ndërlidhësit me komunitetin;
- Qytetarët e zonës.

Takimi u hap me fjalën përshëndetëse të administratorit të Njesisë Administrative Paskuqan, z.Fatjon Kordhaku, ku i njohu qytetarët për qëllimin e takimit.

Më pas fjalën e mori kryetari i Bashkisë Kamëz, z. Rakip Suli, i cili pasi falënderoi pjesëmarrësit në takim, ftoi qytetarët që të japin sugjerimet dhe komentet e tyre për buxhetin e vitit 2025. Gjatë fjalës së tij, kryetari i Bashkisë Kamëz, z.Rakip Suli vuri theksin te rëndësia e komunikimit dhe vendimmarrjes së përbashkët: “ Ne të gjithë bashkë besoj që kemi gjetur rrugën e komunikimit, rrugën e diskutimit dhe të vendimmarrjes së përbashkët, për menaxhimin e të ardhurave të Bashkisë Kamëz. Ne kemi marrë iniciativën

për të shkuar në çdo njësi, për të diskutuar së bashku, për të informuar qytetarët, për punët e bëra dhe për planifikimin e projekt-buxhetit për vitin 2025”, u shpreh z.Suli.

Kryetari z.Rakip Suli u ndal edhe te punët e bëra nga Bashkia Kamëz gjatë këtyre 5 viteve. “ Në 2019 e gjetëm Bashkinë Kamëz me 609 milion dollarë të ardhura dhe në 2024 e çuam në 2.2 miliard dollarë të ardhura, këtë e arritëm fal mirëmenaxhimit të fondeve të Bashkisë. Sot, mbi 68% e buxhetit të Bashkisë Kamëz shkon për investime. Investuam në objektet arsimore, sepse një popull që ka dije ka zhvillim, dhe ne bëmë revolucion në arsim gjatë këtyre 5 vite. E gjeta Kamzën pa asnjë çerdhe dhe me shkolla e kopshte në gjendje të mjeruara. Edhe po t’i mbledhim 61 bashkitë e vendit nuk kanë investuar në arsim aq sa ka investuar Bashkia Kamëz në këto 5 vite. Gjitashtu gjatë këtyre viteve bëmë punë kolosale në çdo njësi duke investuar në infrastrukturë, ujësjellës, kanalizime dhe po ashtu falë politikave sociale të mirëfillta iu erdhëm në ndihmë familjeve në nevojë dhe biznesit, duke ju lehtësuar taksat, dhe duke ju ofruar shërbime falas”, deklaroi kryebashkiaku Suli.

Punët e bëra në këto 5-vite

➤ Investimet 2019-2024, Bashkia Kamëz

- Ndërtimi i Parkut të Paskuqanit
- Vitin e parë në Paskuqan përfunduar urën;
- 40 objekte arsimore, nga të cilat 11 objekte arsimore në Njësinë Paskuqan, 2-gjimnaze, 4 shkolla , 2 çerdhe.
- Infrastrukturë rrugore 195km, nga të cilat në Njësinë Paskuqan janë investuar 73km, rreth 148 rrugë.
- Ujësjellës 195 km, ku në Njësinë Paskuqan janë investuar rreth 22.3 km ujësjellës. E gjithë zona e Paskuqanit është e mbuluar 100% me ujë të pijshëm. Babroi është i mbuluar rreth 61% me ujë të pijshëm.
- Kanalizime 125 km, nga të cilat në Njësinë Paskuqan janë investuar rreth 73km kanalizime.
- 54 pallate të rehabilituara, nga të cilat në Njësinë Paskuqan janë rehabilituar 18 pallate me rreth 272 familje përfituese.
- Rindërtimi nga tërmeti : 426 banesa individuale
- Pallate Valias : 19/270 apartamente

- Ambiente sportive
- Ndërtimi i Shëtitores së Bathores.
- Krijimi i stacionit zjarrfikës në Valias.
- Blerja e makinave të pastrimit të qytetit.

➤ ***Të Rinjët***

- 630 bursa ekselence.
- 162 ekupe sportive / 1550 të rinj.
- Panairi i Librit “Kamza Lexon”.
- Klubi i Librit.
- Konkurse artistike për të rinjtë.
- Këshilli Rinor.
- Praktika Pune.
- Kurse profesionale.
- Karta e studentit.

➤ ***Taksa dhe Tarifa vendore***

- Tarifa 0 për çdo biznes të ri (për 1 vit), nga 28.000 lek/Viti në 0 lek/Viti Viti 2021-2024 (1519 subjekte perfituese).
- Ulja e tarifave dhe taksave me 60 % Viti 2022-2024 (3978 subjekte përfituese).

Kategoritë	2019	2024
Pensionistët	6000	1200
Invalidet e punës, të verbërit, paraplegjik dhe tetraplegjik	6000	1800
Familjet qe trajtohen me ndihmë ekonomike	6000	0
Familjet që trajtohen nga PAK	6000	2000
Kryefamiljare femra me më shumë se një femijë	6000	1800

- Numri i përfituesve nga ulja e taksës familjare për vitin 2023

Përfitues 2023	
Ndihme ekonomike	528
Invalid	1453
Pensionist	2225

➤ **Politikat Sociale**

- Taksa 0 për familjet në nevojë .
- Kopshte/çerdhe pa pagesë, 500 fëmijë.
- Qendra Multifunktionale, 99 fëmijë.
- Familje me bonus qeraje nga strehimi social 752.
- Kredi të buta 74 familje
- Rehabilitimi i banesave.
- Punësimi i personave me aftësi ndryshe.

Kryetari i Bashkisë Kamëz, z.Rakip Suli, u ndal edhe tek investimet që do të bëhen në Njësinë Administrative Paskuqan gjatë vitit 2025.

Investimet e parashikuara në projekt-buxhetin e vitit 2025 për Njësinë Administrative Paskuqan.

- Infrastrukturë rrugore: 21.4 km, 79 rrugë
 - Në Paskuqan 1 do të investohet në 18 rrugë.
 - Në Kodër të Kuqe do të investohet në 21 rrugë
 - Në Babrru Qendër dhe Babrru Kodër do të investohet në 16 rrugë
 - Në Paskuqan 2 do të investohet në 26 rrugë
- Kopshti në Babrru
- Projekti i Parkut të Liqenit:

- Amfiteatri
- Kënde Lojrash
- Pedonale
- Tualetë publike
- Shkallë Panoramike

Pas diskutimit interaktiv me qëllim nxitje, përfshirjen qytetarëve në diskutim për buxhetin 2025, përfaqësuesit e Bashkisë bënë me dije banorët se çdo kërkesë, ankesë dhe sugjerim i tyre ishte i vlefshëm dhe do të shqyrtohet për t'u implementuar në buxhetin e Bashkisë Kamëz 2025.





Adresa: Bulevardi "Nënë Tereza", nr. 492 Kamëz, tel.: +355 47 200 177, e-mail: info@kamza.gov.al, web: www.kamza.gov.al

